

ARSIMI NË SHKODËR I SUBVENCIONUAR NGA PERANDORIA AUSTRO-HUNGAREZE GJATË PERIUDHËS 1908-1912

Nga Revolucioni Xhonturk deri në Shpalljen e Pavarësisë

Dr. Marsel NILAJ, Universtiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

marsel.nilaj@unishk.edu.al

Abstrakt

Revolucioni Xhonturk i vitit 1908 solli një riorientim të politikave osmane ndaj popujve jomyslimanë në Ballkan. Në këtë kontekst, Perandoria Austro-Hungareze intensifikoi ndikimin e saj në vilajetet shqiptare, veçanërisht në qytetin e Shkodrës, përmes mbështetjes së arsimit. Vjena përkrahu si shkollat katolike, ashtu edhe institucionet laike, duke ndikuar në krijimin e një elite arsimore shqiptare. Pas Kongresit të Manastirit dhe miratimit të alfabetit të përbashkët, Austria e përdori subvencionimin e arsimit shqip si pjesë e një politike të jashtme kulturore, për të përballuar ndikimin sllav në rajon. Arsimi mori kështu një rol të dyfishtë: si simbol i identitetit kombëtar shqiptar dhe si instrument i diplomacisë austriake. Në një kohë zhgënjimi ndaj qeverisjes xhonturke, Austria shihej si përkrahëse e çështjes shqiptare, duke ndikuar në proceset që çuan në shpalljen e Pavarësisë më 1912.

Fjalë çelës: Shkodra, Vjena, Xhonturqit, Arsim, Manastir.

Education in Shkodra subsidized by the Austro-Hungary empire during the period 1908-1912

From the Young Turk Revolution to the Declaration of Independence

Abstract

The Young Turk Revolution of 1908 reshaped Ottoman policies toward non-Muslim populations in the Balkans. In this changing landscape, the Austro-Hungarian Empire increased its influence in the Albanian vilayets, particularly in Shkodra, by investing in education. Vienna supported both Catholic and secular schools, helping form an emerging Albanian intellectual elite. After the Congress of Manastir and the adoption of a unified alphabet, Austria integrated the funding of Albanian-language education into its cultural foreign policy to counter Slavic influence in the region. Education thus served a dual role: as a symbol of Albanian national identity and as a tool of Austro-Hungarian diplomacy. Amid growing disillusionment with Young Turk governance, Austria was increasingly seen as a supporter of the Albanian cause, contributing to the developments that led to the Declaration of Independence in 1912.

Keywords: Shkodra, Vienna, Young Turks, Education, Manastir.

Hyrje

Gjuha shqipe ishte e vetmja ndër gjuhët ballkanike që ende nuk kishte një formë të shkruar të standardizuar. Megjithëse zgjimi i saj erdhi me vonë, ajo po rifitonte me vrull pozitën që i takonte, duke synuar të zinte vendin e merituar në jetën kulturore dhe kombëtare. Shqiptarët, të cilët kishin dhënë një kontribut të rëndësishëm në ardhjen e Xhonturqve në pushtet, për herë të parë po përfitonin nga konjunkturat ndërkombëtare – si brenda, ashtu edhe jashtë Perandorisë Osmane – për të kërkuar të drejtat që u takonin. Ndërkohë, arsimit dhe kultura po shndërroheshin në çështjet më të ndjeshme kombëtare, të cilat vetë shqiptarët nuk ishin më të gatshëm t’i injoronin. Në këtë sfond, përfaqësues të Fuqive të Mëdha, në veçanti Perandoria Austro-Hungareze, ofruan mbështetje konkrete në fushën e arsimit, duke kontribuar drejtpërdrejt në përpjekjet e shqiptarëve për emancipim kombëtar dhe kulturor.

Shoqëria “Bashkimi” mbetet një ndër shoqëritë më të vjetra të krijuara në zonën e Shkodrës, lidhur me problemin e alfabetit shqiptar. Ajo u krijua nga Abat Preng Doçi, në bashkëpunim me At Gjergj Fishtën dhe Dom Ndoc Nikën, ku të dy ishin njerëzit më të afërt të tij që në 1899.⁶² Të dy këto ndihmuan të krijohej edhe Alfabeti që u njoh për një kohë të gjatë si “Alfabeti i Bashkimit” dhe që pati impakt të madh edhe në krijimin e Alfabetit të Manastirit në 1908.⁶³ Por mbështetjen më të madhe nga të gjithë ia dha Faik Konica. Ai me revistën e tij “Albania”, të cilën kishte zgjedhur ta shkruante me anë të alfabetit të “Bashkimit”, i kishte bërë nderin më të madh këtij alfabeti, duke e popullarizuar edhe përtej trojeve shqiptare, duke qenë se dilte jashtë vendit dhe kishte ndikim në të gjithë çarqet ku kishte komunitetet shqiptare. Vetë Konica deklaronte se ky alfabet ka zënë rrënjë të forta ndër shkrimtarët shqiptarë dhe ato që nuk e pranojnë, janë ato që nuk shohin përtej lokalizmit të tyre.⁶⁴

Ky alfabet pati ndikim të madh edhe ndër kolonitë shqiptare edhe përtej ndikimit të Konicës, për faktin se Alfabetin e Stambollit e kishin vështirë ta shtypshkruanin me shtypshkronjat e stilit evropian, dhe se koloni të tilla si edhe ajo e Kajros, e cila mund ta kishte më afër ndikimin e Alfabetit të Stambollit, kishte kërkuar të shkruante me anë të Alfabetit të Shoqërisë “Bashkimi”.⁶⁵

Por në qoftë se në qarqet shqiptare ndikimi i alfabetit të “Bashkimit” ishte në rritje në prag të Kongresit të Manastirit, për austriakët kjo nuk ishte gjë e mirë, dokumentacioni i pasur austriak i konsullatës së Shkodrës dhe i qendrave të tjera të vilajeteve shqiptare jep një këndvështrim tjetër për këtë alfabet dhe këtë shoqëri. Këndvështrim të rrënjësor në interesat e austriake lidhur me këtë çështje. Vjena shihte tek Shoqëria “Bashkimi” ndikimin e Italisë dhe kjo e bënte më së shumti të kundërshtonte veprimtarinë e Abat Doçit. Ato ndiheshin të shqetësuar se në fillim të janarit 1908, kur po bëhej thirrje për të futur në masë në shkollat katolike përdorimin e këtij alfabeti, nga Shoqëria “Bashkimi”, i pranishëm ishte edhe konsulli italian. Madje shqetësues ishte edhe fakti, se fjalori i ri shqip i “Bashkimit”, i cili edhe pse mbante siglën “Bashkimi” për autor kishte dom Dodë Kolecin,⁶⁶ në shumë prej fjalëve kishte përkthimin italisht, kurse në shqip shumë fjalë kishin theksin mirditor.⁶⁷ Shqetësimi në këtë aspekt ishte i dyanshëm së pari, se përdorimi i italishtes do nguliste shqiptarët më afër kësaj

⁶² Kraja, Musa. “Mësuesit për kombin shqiptar”, Tiranë: Toena, 1993, f. 353.

⁶³ Marku, Dr. Paulin. “Abat preng Doçi, kleriku, atdhetari dhe intelektual shqiptar”, në *Kumbona e së Diellës*, Nr. 7ç8, korrik – gusht 2024, f. 28-31, f. 28.

⁶⁴ Kastrati, Jup. “Faik Konica (jeta dhe vepra)”, Tirane: Kristalina-KH, 2022, f. 224.

⁶⁵ Demiraj, Shaban. & Prift, Kristaq. “Kongresi i Manastirit”, Tiranë: A.SH.SH., 2008, f. 71.

⁶⁶ Ndoj, Gjet. “Antologji Historike. Themele të ruajtura të një shtëpie evropiane të shembur”, Tiranë: Geer, 2009, f. 148.

⁶⁷ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1908, f.172-173, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar Markezit von Pallavicini, Stamboll, dt. 12.04.1908.

gjuhe dhe do i largonte nga ndikimi i gjermanishtes, kurse theksi mirditor shihej si ndikim më i madh i Abat Doçit të cilin e shihnin si mbështetësin më të madh të ndikimit italian, sipas austriakëve.

Shoqëria "Bashkimi" kërkonte me çdo kusht të ushtronte ndikimin e vet, saqë nëpërmjet Preng Bib Dodës i kërkoi edhe Kongresit të Manastirit me anë të një letre të mbështetëj alfabeti i "Bashkimit" sepse Mirdita mbështet këtë alfabet, kur në një kohë Preng pasha nuk ka aspak lidhje me çështjet e alfabetit, dhe njëkohësisht mbështetet më shumë ndikimin xhonturk shpreheshin austriakët.⁶⁸ Por lidhja e tij me xhonturqit del edhe nëpërmjet lobimit që bëri dega xhonturke e Shkodrës në Stamboll, të cilët kërkuan që ta sillnin në Mirditë që kjo zonë të mbështeste xhonturqit pas ardhjes në pushtet. Kjo gjë ishte planifikim vetëm i tyre saqë edhe ai vet u habit kur e pritën aq mirë në Mirditë pas shumë vitesh internim në Stamboll.⁶⁹ Por Preng pasha nuk shihej si person i dëmshëm për interesat austriake, ai më shumë cilësohej si një person që ruante më shumë interesat e Mirditës, por që nuk dëmtonte interesat kombëtare në çështjen e Alfabetit. Ashtu sikurse vlerësohet në një moment edhe Abat Doçi, i cili diti të tërhiqej në momentin kur At Fishta dhe Dom Ndoc Nikaj e këshilluan të tërhiqej, nëse donte të ruhej nga njolla e dëmtimit të interesave kombëtare, në lidhje me alfabetin.

Alfabeti i dytë i Shkodrës ishte ai i Shoqërisë "Agimi", i cili ishte një derivat i hershëm i shoqërisë "Bashkimi", i dalë dhje i mbajtur nga vëllezërit Mjeda, por kryesisht dom Ndre Mjeda. Për shumëkënd shoqëria "Agimi" ishte inekzistente, ajo mbahej në këmbë nga austriakët me subvencionet e tyre, dhe me botimet që bënte vetë Dom Ndre Mjeda.⁷⁰ Mjeda kishte krijuar një alfabet me një sistem shkronjash që e përdorte edhe kroatishja në atë kohë,⁷¹ dhe që ishte e vështirë t'i rezistonte kohës dhe të përdorej me lehtësi nga masa e shqiptarëve. Kur Mjeda e pa që nuk po arrinte të fitonte terren, ai edhe në Kongresin e Manastirit mbështeti alfabetin e Stambollit, si më të përshtatshmin.⁷² Kjo si një kundra përgjigje ndaj alfabetit të "Bashkimit". Acarimi mes dy shoqërive të Shkodrës ishte aq i madh saqë edhe Abat Doçi, fitoren në Kongres e pa më shumë si një fitore mbi partinë e Mjedës.⁷³ Vetë austriakët e shihnin këtë rivalitet si një mistikë biblike, duke i krahasuar me luftën mes Kainit dhe Abelit,⁷⁴ por nëse te Mjeda shihnin personin e matur dhe të qetë, tek Abat Doçi shihnin njeriun që me çdo kusht kërkonte mbështetje për alfabetin e vet.⁷⁵ Kjo ndasi që kishte çuar shoqëritë në tejskaje, kishte krijuar një panoramë në Shkodër, në të cilët flitej për një alfabet italian dhe për një austriak.⁷⁶

Por austriakët duke e parë që ndikimi i tyre në lidhje me alfabetin dhe me shoqërinë "Agimi" po binte, kërkuan nëpërmjet vëllezërve Mjeda të krijonin një shoqëri të përbashkuar mes dy shoqërive ekzistuese, por Doçi nuk pranoi, ai tashmë triumfator por edhe për t'iu larguar ndikimit austriak, e ruante Shoqërinë "Bashkimi", më shumë se ruante Anglia, Indinë.⁷⁷ Ndërkohë që Faik Konica veprimin e Vëllezërve Mjeda e çuan si të pamenduar në atdhedashuri, veprimin e austriakë e quan të papjekur.

⁶⁸ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f.27-29, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 06.07.1909.

⁶⁹ Gawrych, George. W. "Gjysmëhëna dhe shqiptarja", Tiranë: Bota Shqiptare, 2007, f. 243.

⁷⁰ Ndoj, Gjet. "Antologji Historike...", f. 134.

⁷¹ Bala, Smajl. "Historiku i shkollave dhe mësuësit e Shkodrës (1662 – 1945) Vëll. I" Shkodër: Rozafat, 2011, f. 155.

⁷² Hoxha, Fiqiret. "Vatër e dijes shkodrane 100 vjet Shkolla 9 vjeçare Ismail Qemali", Tiranë: Albas, 2014, f. 52 – 53.

⁷³ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f.111-113, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 19.04.1909

⁷⁴ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1908, f.341, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 09.11.1908.

⁷⁵ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1908, f.118-120, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar Markezit von Pallavicini, Stamboll, dt. 26.11.1908.

⁷⁶ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1908, f.119, Po aty.

⁷⁷ Ndoj, Gjet. "Antologji Historike...", f. 135.

Sepse pikërisht librat me alfabetin "Bashkimi" që në fillim i botoi Vjena, pasi ajo i hodhi për mbështetje të Mjedës, u morën nga shkollat italiane, duke dëmtuar më shumë ndikimin e Vjenës në Shkodër.⁷⁸

Kongresi i Manastirit i 14 – 22 nëntorit 1908 ishte veprimtaria më e madhe politike dhe kulturore që shqiptarët krijuan që pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 1878 - 1881⁷⁹ ajo ishte bërë një domosdoshmëri për të sjellë në jetë një organizim kulturor, në mesin e një kaosi kulturor dhe paditurie njëkohësisht. Shqiptarët në atë kohë flisnin në shqip, osmanisht, apo disa që dinin gjuhë të huaja perëndimore përdornin shprehje të këtyre gjuhëve për përshëndetje apo për të komunikuar. Një element i tillë ishte edhe në Shkodër, i cili ishte qyteti që kishte potencialin më të madh që të kishte një kulturë kombëtare me frymë perëndimore. Ndër të parët që nisi të kthente përshëndetjet e huaja, të cilat kishin në përdorim edhe gjuhën e besimit që personat kishin, ishin mësuesit e brezit të kohës së Kongresit të Manastirit, si Mati Logoreci, Kolë Kodheli, Ndue Paluca, Gasper Beltoja etj.⁸⁰ Ato nisën të përshëndesnin në shqip dhe kjo gjë nisi të bëhej joshëse dhe moderne për të rinjtë. Por ndasia në mes alfabeve, të cilët në Shqipëri më të përdorshmit ishin 5; ai i Frashërllinjve, ai grek, ai i jezuitëve, ai i "Bashkimit" dhe ai i "Agimit",⁸¹ kishin dëmtuar zhvillimin e shkollës shqipe dhe kishin lënë shumë mbrapa shqiptarët. Manastiri pati një ndikim të fortë edhe në psikologjinë e popullit shqiptar dhe në ndikimin emocional fetar. Përfaqësuesi i delegacionit të Stambollit, Haxhi Vildan Efendi u shpreh se nuk kishte lidhje alfabeti me besimin, se edhe shqiptarët mysliman, mund të besonin në besimin islam, por mund të shkruanin edhe me shkronja latine, deklarata që ia bëri edhe konsullit austriak në Shkodër Kral.⁸² Ndërkohë që alfabeti Frashëriot më shumë përdorim kishte në zonën e Korçës dhe nga familja Çiriazit të cilët kishin hapur edhe shkollën e Korçës, kurse zonat përtej më zbehtazi.⁸³

Një ndër ndikimet më të mëdha në çështjen e alfabetit dhe kulturore sidomos gjatë viteve 1908 – 1910 ishte ndikimi që kishte elementi politik xhonturk. Kur gjuha shqipe tashmë kërkonte me çdo kusht të formësohej me frymën latine dhe pro perëndimore xhonturqit menjëherë u hodhën në reagim dhe veprim. Për to ishte e papranueshme që një popullsi me shumicë myslimane të shkruante me shkronja latine, duke u larguar nga alfabeti arab osman.⁸⁴ Por gjuha shqipe për shekuj nuk kishte qenë rrezik për osmanët, për aq kohë sa flitej. Kur ajo kërkoi të shkruhej doli në pah si rrezik, sepse me anë të shkrimit idetë ruheshin dhe tejçoheshin tek mijëra vetë njëherazi.⁸⁵ Ato u munduan të fusnin konceptin e nacionalizmit arsimor shqiptar kur me anë të hoxhë Rexhep Tetovës dhe hoxhë Ali Elbasanit hapën një klub në Aksaraj në Stamboll, kundër klube shqiptare "Bashkimi".⁸⁶ Edhe pse gjatë kohës që shqipja po forcohej këto klube me qendër në Stamboll, kishin filluar ta humbnin ndikimin e tyre, dhe nga presioni osman qëndronin vetëm formalisht në këmbë.⁸⁷ Kjo gjë kishte arritur deri në atë pikë sa vetë Luigj Gurakuqi kishte akuzuar Abdyl Ypin, i cili kryesonte klubin "Bashkimi" të Stambollit, si pro xhonturk.

⁷⁸ Kastrati, Jup. "Faik Konica.", f. 226.

⁷⁹ Martini, Luigj. "Abati i Mirditës Preng Doçi 1846 – 1917", Tiranë: Mirgeeralb, 2012, f. 376.

⁸⁰ Nika, Dom Ndoc. "Kujtime të një jetës së kalueme", Tiranë: Plejad, 2003, f. 127.

⁸¹ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f. 125, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 09.11.1908.

⁸² AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1908, f.111-115, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar Markezit von Pallavicini, Stamboll, dt. 31.12.1908.

⁸³ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f. 127, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 09.11.1908.

⁸⁴ Meta, Beqir. (kryered.) "Historia e shqiptarëve gjatë shek. XX (Vëllimi i I)", Tiranë: Botimet Albanologjike, 2017, f. 90-91.

⁸⁵ Nika, Dom Ndoc. "Kujtime të një jetës...", Tiranë: Plejad, 2003, f. 126.

⁸⁶ Vllamasi, Sejfi. "Ballafaqime politike në Shqipëri 1897 – 1942", Tiranë: NERAIDA, 2000, f. 52.

⁸⁷ Shaplo, Siri. "Nga historiku i zhvillimit të arsimit në Shqipëri", Tiranë: Instituti i Studimeve Pedagogjike, 1975, f. 57.

Ndikimi xhonturk del në pah edhe gjatë Kongresit të Manastirit. Vetë Konica shprehet se që në mbyllje të Kongresit të Alfabetit se xhonturqit me anë të ndikimit të tyre, krijuan në Manastir një Kongres sepse kishin marrë vesh se shqiptarët do të krijonin një kongres për alfabetin.⁸⁸ Ndikim që u mbajt edhe në Kongresin e Dibrës nga ana xhonturke, edhe pse shqiptarët tashmë qoftë edhe në mënyrë minimaliste nuk hiqnin dorë nga kushtet e tyre kombëtare.

Në dokumentet austriakë del në pah edhe ky ndikim jo veç nga raportet konsullore por edhe nga deklaratat e personaliteteve që kishin qenë në Kongres. At Gjergj Fishta dhe Mati Logoreci deklarojnë se kishte shumë propagandë xhonturke në Kongres, dhe se mbështetësi më i madh i tyre ishte Mithat Frashëri. Ai u mbështet nga ato për të mbajtur alfabetin Frashëriot.⁸⁹ Ndërkohë që shumë prej personaliteteve nuk reagonin sepse frikoheshin se mund të quheshin si pro austriak, një pjesë tjetër kishin frikë të reagonin sepse e kishin mirë me xhonturqit dhe rrezikonin postet që mbanin.⁹⁰

Mbajtja e dy alfabeteve dhe justifikimi se edhe gjermanët mbanin alfabetin latin dhe gotik, u kundërshtua sepse dallimin mes tyre e kishin tipografik, kurse dallimi mes dy alfabeteve tanë ishte ortografik. Por ky argumentim u bë për të ulur gjakrat tek mbështetësit proaustriak, të cilëve iu gjet pikërisht shembulli që mund t'i lidhte më së miri. Megjithatë çdo ndikim kur bëhet artificialisht nuk frymëzon në kohë, ndaj edhe me kohën dhe alfabeti frashëriot nuk la gjurmë dominuese në nivelin kulturor të të ardhmes.

Shkodra në atë kohë ishte një ndër zonat që përfaqësohej më denjësisht brenda Kongresit të Manastirit, ndër 6 personalitete që ishin nga besimi katolik, sikurse ishin: At Gjergj Fishta, Dom Ndre Mjeda, Hilë Mosi, Mati Logoreci, Luigj Gurakuqi dhe Dom Nikollë Kaçorri, vetëm ky i fundit nuk ishte nga Shkodra. Ato të gjithë kishin qenë edhe më parë personalitete që ishin marrë edhe me veprimtari arsimore dhe letrare duke dhënë kontribut edhe para Kongresit. Në fakt të tre alfabetet që po shqyrtoheshin nga komisioni i përzgjedhur, të tre ishin me karakter latin, ndaj edhe ky kongres kishte vendosur padyshim që alfabeti të ishte me fryme latine.⁹¹

Mati Logoreci ishte për një alfabet përbashkues që të mos kishte hatër-mbetje, apo edhe përçarje, ku në të njëjtën ide ishte edhe Hilë Mosi, por që kjo nuk pati peshë. Ndërkohë që personalitetet që patën më shumë ndikim ishin At Gjergj Fishta dhe Luigj Gurakuqi.

At Fishta, i cili në atë kohë ishte në moshën 37 vjeç, dhe që u vendos në krye të Komisionit Përzgjedhës të Alfabetit, shihej një poet i talentuar dhe një ndër gjuhëtarët më të njohur të kohës.⁹² Ai së bashku me Gurakuqin dhe Logorecin ishin nisur nga Shkodra me subvencionimin e rrugës për në Manastir nga konsullata austriake në Shkodër,⁹³ kundrejt një shumë prej 55 napolonash, por asnjë moment nuk kishte mbetur peng i interesave të Vjenës në Kongres. Përkundrazi Fishta kishte qenë një person i cili kishte ditur të ruante ekuilibrat gjatë bisedimeve përzgjedhëse të alfabetit, dhe kishte shpëtuar nga akuzat ndaj tij për njëanshmëri.

Por personi që dha më shumë kontribut nga personalitetet që vinin nga zona e Shkodrës brenda kongresit mbetej Luigj Gurakuqi. Aktiviteti i tij kishte nisur për këtë qëllim që përpara fillimit të

⁸⁸ Kastrati, Jup. "Faik Konica.", f. 224.

⁸⁹ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1908, f. 81-83, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 15.12.1908.

⁹⁰ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f. 111-113, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 19.04.1909.

⁹¹ Kraja, Musa. "Mësuesit për kombin...", f. 251.

⁹² Prifti, Kristaq. "Shkrime historike për Rilindjen Kombëtare", Tiranë: Adel-co, 2016, f. 422-423.

⁹³ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f. 14-15, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 07.01.1909.

Kongresit. Gurakuqi që në fillim të 1908 bashkëpunoi me Bajo Topullin, për fillimin e një kryengritje nga pjesa e veriut të trojeve shqiptare,⁹⁴ për t'iu çasur sjelljeve kundërshtuese ndaj perandorisë edhe në këto anë. Ai dy javë pasi kishte ardhur në Shkodër, nisi një turne në çarqet shqiptare në Shkup, Manastir dhe Selanik, ku i fliste për nevojën për një alfabet përbashkues. Gurakuqi i dërgoi një letër që me 8 nëntor 1908 Feim Zavalanit, drejtuesit të klubit "Bashkimi" të Manastirit si iniciuesi i kongresit, duke i kërkuar që të përfshihej me patjetër edhe Faik Konica dhe të ishte sa më përbashkues për të gjithë.⁹⁵ Në Kongres atij iu dha e drejta që të hapte dërrasën e zezë ku ishte shkruar alfabeti final, duke i njohur një nderim për kontributin e tij arsimor dhe atdhetar.

Nga ana tjetër Gurakuqi edhe përtej Kongresit u mor me veprimtarin arsimore dhe mbi të gjitha me parandalimin përçarës në këtë aspekt. Duke qenë se xhonturqit nuk mundën që të mbanin Kongresin e Alfabetit në Stamboll, dhe veprimtaria në Manastir nuk doli sipas parashikimeve të tyre, kongresin e dytë për alfabet kërkonin ta mbanin me ndikimin e klubit të selanikut fill pas Kongresit të Manastirit, në Elbasan. Por do të ishte këmbëngulja e Luigj Gurakuqit që me anë të një letre i kundërshton fort Mithat Frashërit, që të lejonte xhonturqit që të mbanin menjëherë një kongres në Elbasan.⁹⁶ Edhe pse kongresi u mbajt në Elbasan në 1909, tashme koha ishte shumë më e largët se qëllimi xhonturk, e mbi të gjitha në pamundësi të realizmit të atyre qëllimeve.

Veprimtaria e personaliteteve të Shkodrës nuk mund të shihet pa u pa situata në Shkodër, ndikimet e të gjithë krahëve politik, kulturor apo fetar të kohës të përfshirë gjatë kësaj periudhe 5 vjeçare në trojet shqiptare. Marrëdhëniet e tendosura me pushtetin e Stambollit dhe marrëdhëniet me opozitarët e qeverisjes qendrore kishin nisur nga Shkodra që gjatë dekadave të fundit të shekullit XIX. Shkodra që nga 1881 kishte qenë nën administrimin e një guvernatori ushtarak për shkak se ajo nuk kishte pranuar të paguante taksat. Madje popullsia katolike e Shkodrës ishte e pakënaqur se dy përfaqësuesit që kishte Shkodra në parlamentin osman të dy ishin të besimit islam.⁹⁷ Ndërkohë që nga 12 000 ushtarë që ishin për të mbrojtur kufirin osman përballë malazezëve, rreth 5 000 prej tyre ishin për të mbajtur sundimin osman në qytet.

Marrëdhëniet me Xhemijetin "Bashkim e Përparim" në Shkodër ishin të hershme. Ato kishin degën e tyre në Shkodër që në mesin e viteve 1890, ku kishte vulën dhe firmën e vet,⁹⁸ dhe informonte për të gjithë veprimtarinë politike të zonës shqiptare.

Njëkohësisht shoqëria "Bashkimi" u regjistrua në 1899 si një shoqëri me karakter fetar duke fshehur elementin kombëtar. Ajo ishte krijuar përpara fillimit të frymës xhonturke në kulturë, si një kundra përgjigje ndaj krijimit të alfabetit Frashëriot.

Por situata ndryshoi gjatë vitit 1908. Ashtu sikurse në të gjithë territoret shqiptare edhe në zonën e Shkodrës pati një besim në lirinë mbi të gjitha kulturore që mund të gëzonin shqiptarët falë, premtimeve të dhëna nga xhonturqit, si rezultat i ndihmës së dhënë nga shqiptarët për ardhjen e tyre në pushtet. Ajo që i gëzoi më shumë shqiptarët shprehet Dom Ndoc Nikaj ishte largimi i fanatizmit fetar të vjetër që po shkatërronte perandorinë,⁹⁹ edhe pse shqiptarët nuk dinin gjë se ç'ndikim kishte koncepti kushtetutë. Ndërkohë që malësorët i kërkuan xhonturqve të sapo ardhur largimin e kreut (segede) të

⁹⁴Kraja, Musa. "Mësuesit për kombin...", f. 219.

⁹⁵ Prifti, Kristaq. "Shkrime historike...", f. 422.

⁹⁶ Tako, Pirro. "Luigj Gurakuqi Jeta dhe Vepra", Tiranë: 8 Nëntori, 1980, f. 108-109.

⁹⁷ Gawrych, George. W. "Gjysmëhëna...", f. 244.

⁹⁸ Toleva, Teodora. "Influenca e Perandorisë Austro – Hungareze në ndërtimin e kombit shqiptar 1896 – 1908", Tiranë: Dudaj, 2018, f. 306

⁹⁹ Nika, Dom Ndoc. "Kujtime të një jetës...", f. 149.

Komitetit për malësitë e Shkodrës. Me këto veprime Shkodra po gëzonte liritë që asnjëherë nuk i kishte parë për rreth 3 dekada me rradhë.¹⁰⁰ Por personat që në fakt nuk i besuan shumë kushtetutës dhe stilit xhonturk ishin Abat Dçi dhe Edit Durham, ku kjo e fundit e quante kushtetutën e 1908, asgjë më shumë se një marifet islamik, "një rreng i djallit".¹⁰¹ E në fakt situata në Shkodër ishte vetëm një tis i hollë lirie, i cili u plasarit dhe u shqye pa nisur mirë, dhe shumë më herët se në të gjithë pjesët tjera shqiptare.

Menjëherë pas mbylljes së Kongresit të Manastirit përfaqësuesit kryesor të klubit "Bashkimi" të Stambollit Haxhio Vildan Efendi dhe Abdyl Ypi erdhën në Shkodër, për të propaganduar pro alfabetit të ri latin të Manastirit. Pritja në qytet iu bë shumë e vakët nga krahu mysliman, madje nuk u lejua të fliste në xhaminë kryesore të qytetit dhe duke i bërë të iknin të zhgënjyer nga qyteti.¹⁰² Ndërkohë që vetë konti Kral nga Shkodra i shprehej me anë të një letre markezit Pallavicini në Stamboll se çështja Alfabetit në Shkodër po rri shumë indiferente.¹⁰³ Ndërsa në shkollat e besimit islam as që pranojnë duke thënë se këto shkronja nuk janë shkronjat e kuranit.¹⁰⁴ Për austriakët në Shkodër ka një dallim të vogël ndërmjet osmanëve të Abdyl Hamidit dhe xhonturqve të sotëm dhe radikalëve islamik të qytetit, ndërkohë që katolikët e kanë të pamundur të shprehen plotësisht dhe ndihen të frikësuar.¹⁰⁵ Niveli i fanatizmit shpeshherë shihej edhe përtej nivelit të radikalizmit xhonturk. Pasi në Shkodër nuk merrej parasysh as rregulli që vetë xhonturqit kishin vënë që në shkollat Ibadije Osmane të futej gjuha shqipe, madje kjo po të ndodhte, do i lihej faji krahut katolik.¹⁰⁶ Madje Vjena shprehet se xhonturqit nuk patën nevojë të bënin asnjë propagandë antikombëtare në Shkodër, sepse ajo ishte e pranishme pa ndihmën e tyre.¹⁰⁷

Në vjeshtën e 1908 xhonturqit shpërndanë klubin "Bashkimi" të Shkodrës,¹⁰⁸ ndërkohë që në pranverë të 1909 komiteti "Bashkim e Përparim" i Shkodrës me anë të hoxhallarëve zhvilluan një agjetacion të fortë në qytet që të mos pranohej alfabeti latin për shqipen.¹⁰⁹ Tashmë xhonturqit përdornin elementin e fanatizmit fetar, ku elementi fetar i përfshirë në frymë politike që nga koha e Abdyl Hamidit, kërkonte që të pranohej çdo lloj ndryshimi në shtet vetëm nëse ishte i pranueshëm brenda normave të islamit.¹¹⁰

Po në 1909, në kongresin e Elbasanit, kongresin arsimor që ishte shumë i rëndësishëm dhe ekuivalent me atë të Manastirit, nga Shkodra nuk pati asnjë përfaqësues. Madje Shkodra si qendër vilajeti, nuk luajti as rolin që duhej që të lajmëronte qytetet tjera vartëse për hapjen e këtij Kongresi.¹¹¹ Në këtë kongres që u mbajt 2 – 8 shtator 1909, u kërkua nga shqiptarët që osmanët të mos ndërhyjnë që shqiptarët të osmanizoheshin me anë të alfabetit apo me dhunë. Njëkohësisht t'u lihej atyre të zgjidhnin alfabetin që doni për gjuhën e tyre. Roli i faktorit xhonturk dhe elementeve konservator pro osman nga

¹⁰⁰ Bartl, Peter. "Myslimanët shqiptar në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878 – 1912)", Tiranë: Dituria, 2006, f. 242.

¹⁰¹ Durham, Edith. "Shqipëria e Epërme", Tiranë: Botimet IDK, 2013, f. 355.

¹⁰² AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1908, f.114, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar Markezit von Pallavicini, Stamboll, dt. 31.12.1908.

¹⁰³ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f.112, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar Markezit von Pallavicini, Stamboll, dt. 30.03.1909.

¹⁰⁴ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1908, f.114, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar Markezit von Pallavicini, Stamboll, dt. 31.12.1908.

¹⁰⁵ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f. 61, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 06.04.1909.

¹⁰⁶ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f. 63, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 06.04.1909.

¹⁰⁷ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f. 212-214, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar Markezit von Pallavicini, Stamboll, dt. 28.06.1909.

¹⁰⁸ Demiraj, Shaban. & Prift, Kristaq. "Kongresi i ...", f. 59.

¹⁰⁹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, "Historia e popullit shqiptar. Vëll. II Rilindja Kombëtare. Vitet 30 të shek. XIX – 1912". Tiranë: Toena, 2002, f. 402.

¹¹⁰ Meta, Beqir. (kryered.) "Historia e shqiptarëve...", f. 92.

¹¹¹ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f. 52, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 06.04.1909.

Shkodra e përjashtoi praninë e figurave të rëndësishme të Shkodrës të merrnin pjesë. Edhe pse po në këtë kongres u zgjodh që të ishte drejtor i Normales së Elbasanit, Luigj Gurakuqi, falë kontributit të tij të njohur në fushën atdhetare dhe në lëmin e arsimit.

Njëkohësisht Shkodra falë këtyre faktorëve me radikalizëm politik dhe fetar nuk u përfaqësua as në Kongresin e Dytë të Manastirit i mbajtur me 2 – 3 prill 1910. Në të sërish u kërkua që të mos ndërhynte element osmanizues ndër shqiptarë. Ndërkohë që pak muaj më vonë në Shkodër në korrik 1910 hyri me artileri malore dhe 3000 trupa Shefqet Turgut Pasha, duke nisur sërish sundimi ushtarak i tre dekadave më parë.

Të gjithë këto elemente edhe pse kishte shkolla të subvencionuara si nga italianët ashtu edhe nga austriakët, kishte shumë pak njerëz që dinin të shkruanin shqip, më të shumtë ishin në krahun katolik, e shumë më të pakët në krahun mysliman të qytetit, ku një pjesë e tyre edhe kur pranonin të shkruhej shqipja kërkonin me alfabetin arab.¹¹²

Për austriakët ka interes edhe hapja e klubeve shqipe. Në fillimin e vitit 1908 ishin të shqetësuar për situatën e vakët që qyteti i Shkodrës po kalonte edhe në lidhje me pasjen e klubeve kulturore, sidomos pas mbylljes nga ana e Xhonturqve të klubit Bashkimi. Por hapja e Klubit "Gjuha Shqipe" u pa me shumë sy të mirë. Mati Logoreci personi që vlerësohej më së shumti nga grupi i mësuesve të Shkodrës nga ana e konsullatës austriake, shihej si personi cili po kontribuonte më së shumti në hapjen e këtij klubi që në shtator 1908. Ky klub shihej m pjesëmarrje më të madhe nga ana e katolikëve, por që kihej shpresë se edhe shumë mysliman të kulturuar nga qyteti do të aderonin.

Klubi ishte krijuar nga arqipeshkvi Jak Serreqi, por që mendohej t'i lihej në administrim dhe në organizim At Gjergj Fishtës,¹¹³ i cili së bashku me Mati Logorecin kishin rolin kryesor brenda klubit. Ky i fundit mendonte se me krijimin e këtij klubi, përparimi i gjuhës shqipe do të ecte përpara, kuptohet me alfabetin e Manastirit.¹¹⁴ Klubi pati jetën e gjatë deri në periudhën e pavarësisë, pasi shihet se në vitin 1912 tashmë vetë klubi Gjuha Shqipe, i kërkonte konsullatës austriake në Shkodër por edhe me anë të letrave direkte ndaj Ministrisë së Jashtme në Vjenë, që të dhuroheshin libra në shqip ose në gjuhë të huaj për klubin, pasi do të ishin në interes të lexuesve që po shtoheshin.¹¹⁵ Ky element tregonte se tashme gjuha shqipe kishte nisur të stabilizohej mbi kundërshtitë dhe interesi po rritej përtej.

Një rol të madh në këtë kohë luajnë edhe subvencionet të cilat Vjena jepte ndaj shqiptarëve sidomos të Vilajetit të Shkodrës. Duke qenë se konsullata e Shkodrës ishte ajo më kryesorja dhe që kishte interesin më të madh ndër katër qendrat e Vilajeteve, qëllimet austriake ishin shumë dimensionale. Ku një ndër qëllimet kryesore ishte synimi për të mbajtur disa nga personalitetet kryesore, të cilët do i kishte mbështetje për të ushtruar ndikimin e saj në vend.

Subvencionimi i shumë prej personaliteteve shqiptare është një ndër ato veprime kryesore ku në zonën e Shkodrës ndihet prania e fuqisë politike të Vjenës. Personaliteti i Shkodrës i cili gjatë kësaj kohe mori më shumë subvencione ishte At Gjergj Fishta. Ai nga dokumentacioni i shumë austriak shihet si personi i cili ishte më i besueshmi në kuadrin e politikës austriake. At Gjergji ishte personi i cili

¹¹² Nika, Dom Ndoc. "Kujtime të një jetës...", f. 126.

¹¹³ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1911, f. 363-364, Letër e Kontit Zambaur nga Shkodra drejtuar Markezit von Pallavicini, Stamboll, dt. 20.02.1911.

¹¹⁴ Kraja, Musa. "Mësuesit për kombin...", f. 252.

¹¹⁵ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1912, f. 296, Letër e Klubit "Gjuha Shqipe" të Shkodrës drejtuar Kontit Zambaur, Shkodër, dt. 12.01.1912.

shumat e dhëna i jepeshin si për aktivitet kombëtar,¹¹⁶ ashtu edhe për aktivitete letrare,¹¹⁷ e njëkohësisht edhe për veprimtari të kuvendit françeskan. Por ai nuk do të ishte i vetmi. Subvencione mori edhe Dom Ernesto Koci, për botime letrare dhe etnologjike duke u parë si personi i cili për këtë qëllim shkruante edhe në revistat e huaja antropologjike, e po ashtu edhe At Shtjefen Gjeçovi për botime letrare për rininë.¹¹⁸

Nga vitit 1908 deri në vitin 1911 subvencionet ishin më të lirshme dhe i lihej në besim personit të cilit i jepej deri diku përdorimi i lirë i shumës, ndërkohë që pas gjysmës së dytë të vitit 1912, subvencionet që i jepeshin Imzot Jak Serreqit, porositeshin që të mos përdoreshin për qëllime agjetative.¹¹⁹ Situata e nderë e vitit 1912 në aspektin politik e bënte Vjenën më të kujdesshme që fondet personale të mos kalonin në veprimtari të tjera të cilat të dilnin nga kontrolli i planeve të saj politike, si në këtë zonë, si dhe me këto personalitete.

Por shpenzime të mëdha hodhi Austria edhe për shkollime në forma nga më të ndryshmet. Një ndër format më të prekura ishte edhe shkollimi që bëhej ndaj seminaristëve, kandidatëve të rinj për t'u bërë priftërinj. Si në shumë fusha tjera, nga dokumentacioni austriak del në pah se Vjena jo rrallëherë shqetësohet për shkollimin e priftërinjve, mbi të gjitha kahun se ku ato do shkolloheshin. Për Vjenën ishte shumë shqetësuese nëse priftërinj shkolloheshin në Itali, ato madje janë të shqetësuar se provincialët dhe ipeshkvijtë kryesorë shqiptar si Imzot Serreqi, Imzot Guerrini dhe Imzot Doçi një pjesë të seminaristëve tashmë po i dërgonin në Itali. Madje për austriakët kjo ishte edhe shkombëtarizuese. Për Vjenën ky veprim arrin deri në këtë vlerësim sepse ajo shihte të lidhur pazgjydhshëmrisht konceptin e nacionalizmit shqiptar vetëm me Austrinë, dhe me anë të kësaj kërkonte mbajtjen e shqiptarëve të lidhur me interesat e veta.

Por ai që më shumë kishte kundërshti dhe tregojë i ftohtë në këtë aspekt ishte ipeshkvi i Durrësit Imzot Pashk Bardhi, i cili refuzimet e para të Vjenës për dërgimin e seminaristëve në Insbruk, Aty ku pjesa më e madhe e seminaristave shqiptar shkonin, i ishte refuzuar në fillim. Ai duke parë se këtë gjë fare mirë mund ta bënte edhe Italia, kërkesave austriake për t'i dërguar në Austri i përgjigjej me refuzime indirekte, deri edhe për mos dijen e gjermanishtes nga ana e të rinjve seminaristë.¹²⁰ Konflikti i shkollimit të priftërinjve ishte njëri prej konflikteve në interesa që Austria kishte me shtrirjen e ndikimit italian mbi territorin shqiptar, por që shpesh herë ipeshkvijtë e dyzuar ose të lidhur me Italinë e luanin më së miri, ku jo rrallëherë duke treguar edhe një lloj autonomie në veprim.

Një element më rëndësi që vlen të theksohet janë pagesat për shpenzimet e ndryshme që përfshinte ndër shpenzimet për arsimin shqiptar konsullata austriake në Shkodër, edhe për rrogat e mësuesve, si dhe për bursat për studentë të ndryshëm shqiptarë. Në të gjithë shkollat të cilat hargjimet e tyre ishin pjesë e subvencioneve austriake, shohim korrektësinë në kohë në lidhje me pagesat. Rrogat e mësuesve kanë një prioritet të madh, dhe një vëmendje të gjerë nga buxheti i ministrisë së jashtme në Vjenë. Në një kërkesë që i bëhet kësaj ministrie për rritjen e rrogave në fillim të marsit 1909, brenda të

¹¹⁶ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f. 283, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 27.03.1909.

¹¹⁷ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f. 75, Letër e Kontit Lejhanec nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 10.11.1909.

¹¹⁸ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f. 74, Letër nga Vjena drejtuar Kontit Kral, Konsull Austriak në Shkodër, dt. 11.12.1909.

¹¹⁹ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1912, f. 131-132, Telegram nga Vjena drejtuar Kontit Zambaur, Konsull Austriak në Shkodër, dt. 06.08.1912.

¹²⁰ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f. 371-372, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 17.07.1909.

njëjtë muaj merrej miratimi i rritjes së rrogës së mësuesve.¹²¹ Madje dy vjet më vonë, për shkak të situatës së gjendjes së shtetrrëthimit të krijuar gjatë 1911 dhe vështirësimit të jetës, bëhet një rritje si e rrogave, madje u paguhet edhe strehimi të gjithë mësuesve të cilët nuk jetonin në shtëpitë e tyre.¹²² Kjo sjellje të lë të kuptosh se sa rëndësi i jepej mësuesve brenda sistemit austriak të shkollimit në Shkodër, duke qenë se numri i tyre në nivel të arsimit shqip ishte i vogël, ato patjetër kërkonin një stimulim të jetës së tyre me dinjitet, duke i njohur vështirësitë e shumta në punë që ato kishin.

Ndërkohë që ndër shpenzime përfshiheshin edhe bursat të cilët u jepeshin studentëve të ndryshëm, madje deri në atë pikë sa interesoheshin se cilët profesione do kishin interes më shumë, ose edhe për punësimin e bursantëve shqiptarë në Vjenë, për aq kohë sa ishte e mundur. Ndërkohë që të bie në sy marrëdhënia direkte që kishte gjtë vitit 1910, At Gjergj Fishta kur ishte provincial i Kuvendit të Gjuhadorit, me konsullatën austriake. Ai kërkonte me domosdo që të hiqte ndikimin në probandatin e kuvendit, të ndikimit italian dhe me ngadalë edhe tek shkolla e françeskanëve, me qëllimin e rritjes së ndikimit austriak tek të dyja. Duke e parë Austrinë si kontribuuesen më të madhe në lëmin atdhetar,¹²³ ndaj kësaj kërkese Vjena i kërkonte konsullatës së saj në Shkodër që ta merrte me seriozitet dhe të bëhej investimet e nevojshme në çdo lëmë të arsimit që kjo gjë të ishte sa më e lehtë për Fishtën. Veprim që edhe pse kishte interes politik për Austrinë, interesi arsimor për shqiptarët ishte përfitues, por njëkohësisht ky do të ishte edhe fillimi i ftohjes në mes të Fishtës dhe frymës italiane, gjë që vazhdoi derisa At Fishta ndërroi jetë.

Shuma jo të vogla jepeshin në këtë kohë nga Vjena edhe për mbajtjen e shkollave dhe kolegje të ndryshme në Shkodër. Kolegje këto të cilët ishin në frymën e elementit fetar katolik, i cili kishte kontrollin kryesor në sistemin arsimor në vend. Austria në 1909 hapi shkollën e Kuvendit Françeskan të Arrës së Madhe, ku drejtohej nga At Pashko Bardhi dhe kishte një lloj pavarësie në nivelin didaktik të brendshëm, dhe shkollimi ishte në gjuhën Shqipe. Ai subvencionohej kryesisht nga provinca françeskane e Tirolit.¹²⁴

Njëkohësisht në 1910 Shkolla e Motrave Stigmatine ishte e subvencionuar nga konsullata austriake, e cila vetëm për godinën pagoi rreth 2 880 franga ari. Ndërkohë që i gjithë buxheti i arsimit për këtë vit shkonte në 60 000 franga.¹²⁵ Ky investim i madh nga ana austriake ishte fusha, e cila paralelisht me nivelin atdhetar, shqiptarët përfitonin më së tepërmi dhe kjo ishte një ndër arsytet pse Shkodra ishte një ndër zonat që kishte nivelin më të lartë të shkollimit në nivel kombëtar në mes të vilajeteve.

Interes të madh ka edhe për nivelin e botimeve në vend. Në dokumentet austriake del në pah vlera që i jepet mbi të gjitha Imzot Lazër Mjedës, i cili vlerësohet për kontributin e madh që po jep në botime librash, dhe duke u shprehur se ka qenë i gatshëm të bashkëpunojë edhe me grupimin e Doçit, sidomos pas Kongresit të Manastirit, për një unifikim të grupimeve. Për Austriakët problemi ishte Imzot Doçi, i cili në fakt në të shumtën e rasteve ishte shprehur haptazi pro Italisë, dhe largimin e Austrisë nga

¹²¹ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f. 361-362, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 18.03.1909.

¹²² AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1911, f. 488-489, Letër e Kontit Zambaur nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 12.12.1911.

¹²³ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1910, f. 142-144, Letër e At Gjergj Fishtës drejtuar Kontit Zambaur, Konsull Austriak në Shkodër, dt. 22.12.1910.

¹²⁴ Qendra e Studimeve Albanologjike, "Shqipëri – Austri Reflektim Historiografik", Tiranë: Botimet Albanologjike, 2013, f. 198.

¹²⁵ Bala, Smajl. "Historiku i shkollave dhe mësuesit e Shkodrës (1662 – 1945) Vëll. I" Shkodër: Rozafat, 2011, f. 158-159.

ndikimi arsimor.¹²⁶ Element i cili i kishte mbajtur të dy personalitete te kishës larg bashkëpunimit final. Por në aspektin e botimeve vlerë të madhe i jepej Urdhrit të Jezuitëve, të cilët asnjëherë nuk kishin shprehur ambicie për alfabetin, dhe nuk ishin për fshirë në konflikte. Ato me anë të shtëpisë së tyre botuese ishin shumë korrekt dhe mbi të gjitha në shumë raste kishin ulur gjakrat në nivele botimesh, duke pranuar edhe përfshirjen e elementeve të frymës italiane, e po ashtu edhe atyre austriake, në librat e ndryshëm shkollor, kur nuk cenoheshin niveli pedagogjik.¹²⁷ Për këtë vlerësoheshin si një palë e tretë neutrale në rivalitetin kulturor të ndikimit italo – austriak.

Por paralelisht me investimet në godina, apo me trajtimin dinjitoz lidhur me pagesat e rrogave, apo të strehimit të mësuesve, një vëmendje të veçantë nga aspekti austriak i kushtoheshin edhe librave, botimit të tyre si elementi më i rëndësishëm që i jepte formësim arsimi shqip. Lidhur me botimin, përkthimin e blerjen e librave shkollorë ka një dokumentacion që shihet puna serioze e bërë gjatë atyre viteve.

Një pjesë e madhe e librave paguheshin në cilën prej mënyrës së pasjes së tyre me paratë e Austrisë. Që në vitin 1909, kërkohet që për vitin shkollor 1909 – 1910 të ketë një numër ekzemplarësh të librave në shqip prej 16300 kopjesh vetëm për zonën e Shkodrës,¹²⁸ një shumë kjo mjaft e madhe për situatën në të cilën ndodheshim, dhe të gjithë kërkoheshin të ishin me alfabetin e Manastirit. Ky element ishte i përvitshëm, sa që në disa momente kalonte në kuadër të një shqetësimi, që në fund të shkurtit 1910, i kërkoheshin Vjenës që të plotësohej Vilajeti i Shkodrës me librat për vitin 1910 – 1911, në kohën e duhur sepse në të kundërt do të kishte mungesa në fillesat e vitit shkollor.¹²⁹ Ndërkohë që kundrejt çdo kërkesë shtëpia botuese e librit shkollor në Vjenë shprehej se ishte e gatshme që çdo libër që ekzistonte atje ta sillnin falas. Një ndihmesë mjaft e vyer kjo për kushtet në të cilët ndodhej vendi ynë.

Në fund të vitit 1911 i kërkoheshin që për vitin në vazhdim për t'u pajisur në mënyrë sa më të thjeshtë me libra, për të shmangur vonesat në dërgime, aq të dëmshme për procesin mësimor, që kërkesat të bëheshin edhe direkt nga shkollat, ose personat e autorizuar, me qëllim që të shmangej fare kalimi i zgjatur në kohë nëpër ministri të jashtme. Veprim ky i marrë nga veprimtaria e Italisë me shkollat që kishte në Shkodër.

Por njëkohësisht nuk ishte vetëm sjellja nga jashtë apo shtypja por edhe vlerësimi për personat të cilat kontribuonin me botime të ndryshme në shqip. Personaliteti më i shquar në këtë kohë i cili merrej me veprimtari të çmuar të krijimit të librave shkollor ishte Dom Ndre Mjeda. Ai si nga konsullata austriake por jo vetëm shihej si personi i cili punonte në heshtje dhe në mënyrë të palodhur për krijimin e veprave shkollore. Mjeda ishte i vetmi i cili nuk kërkonte as shuma parash për librat e tij, dhe as poste, por merrej me krijimin e librave duke bërë veprimtarinë më të vlefshme për momentin.¹³⁰ Shpeshherë librat e Mjedës nuk ishin të renditur si duhej, por kjo i lihej në dorë shtëpive botuese, ngaqë koha nuk ia premtonte këtë gjë, kjo na jep një fakt mjaft të mirë se puna e dëndur e tij në këtë lëmë, ia privonte kohën për ta parë një vepër me çdo detaj. Ama ai i kërkonte që shkrimi të ishte uniform dhe vepra të kishte rregullsi drejtshkrimore, duke i dhënë seriozitetin që i takonte librave shkollor. Puna që bënte Mjeda ishte

¹²⁶ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f. 111-113, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 19.04.1909.

¹²⁷ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f. 316-319, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 14.07.1909.

¹²⁸ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1910, f. 136-137, Letër nga Vjena drejtuar Kontit Zambaur, Konsull Austriak në Shkodër, dt. 14.10.1910.

¹²⁹ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1910, f. 150-151, Letër e Kontit Zambaur nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 28.02.1910.

¹³⁰ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f. 309-310, Letër e Dom Ndre Mjedës nga Kukli drejtuar Kontit Kral, Konsull Austriak në Shkodër, dt. 20.02.1909.

e vlerësueshme edhe nga At Gjergj Fishta, ku shprehet se Mjeda ishte personaliteti më i padiskutueshëm që në Kongresin e Manastirit¹³¹ dhe duke i njohur atij punën unike në lëmin e pedagogjisë dhe krijimtarisë shkollore.

Mati Logoreci ishte një mësues i shquar që përsëri dha një kontribut të shquar në krijimtarinë e librave shkollor, sidomos me përkthime mjaft dinjitoze, duke bërë punën më patriotike të momentit.¹³² Ai përkthente libra të nivelit shkencor, dhe ato me një korrektësi të madhe. Ai që në 1909 krijoi një shoqëri punëtoresh në Sarreq, një lagje kryesore e Shkodrës, dhe për shëgjertët e zonës hapi të parën shkollë të natës,¹³³ sikurse dha edhe një kontribut te Klubi "Gjuha Shqipe". Njëkohësisht edhe Pader Anton Xanoni cili bashkëpunoi shumë me shtëpinë botuese të Jezuitëve, krijoi librat "Gramatika Shqipe" 1909, dhe "Shkurtorja e historisë së moçme" më 1910. Libra të cilët u vunë në përdorim në të gjithë shkollat që subvencionoheshin nga shkollat austriake.

Një fushë në të cilët ka një kontribut financiar dhe jo vetëm është edhe gazetaria, në të cilët në Shkodër la gjurmë edhe kontributi austriak. Që në 1909 austriakët nëpërmjet Paul Siebert, redaktorit të gazetës austriake Vaterland, i cili kishte ardhur në Shkodër për të parë situatën, kërkojnë në fillim që të bëjnë një shtëpi botuese në vend. Por meqë këtu ekzistonte ajo e jezuitëve dhe ajo e Dom Ndoc Nikës, në të vërtetë bien dakord që të hyjnë në kontakt me këtë të fundit në Obot. Vetë Dom Ndon Nika shprehet se ajo ishte një shtypshkronjë e vogël e krijuar pas marrjes së lejes nga Stambolli dhe me ndihmën e At Fishtës, i cili nëpërmjet njohjeve të tija, porositi bojë dhe letër në Budapest.

Njëkohësisht nga mesi i 1909 qëllimi është të bëhet edhe një gazetë të cilën të përfshihen edhe Dom Ernesto Koci, Luigj Gurakuqi dhe At Gjergj Fishta të cilët të ndihmonin Dom Ndon Nikën, të cilët austriakët nuk i kishin besim,¹³⁴ në shkrimet që mund të bënte, nëse do ishin pro Austrisë. Por austriakët kërkojnë ta mbajnë këtë gazetë edhe në kushtet më të vështira që kalonte Shkodra. Ato e justifikonin faktin se gazeta e Dom Ndoc Nikës nuk kishte shumë shkrime patriotike, përballë Vjenës, me faktin se koha e Shefqet Turgut pashës ishte e vështirë dhe e pamundur. Me anë të kësaj kërkohej vazhdimi i dhënies së subvencionit. Por kjo gazetë me emrin "Besa e Shqypnjes" kishte numra të pakët dhe lexohej kryesisht nga katolikët që dinin më shumë të shkruanin në shqip. Situata ishte e tillë në Shkodër sa që edhe në aspektin e gazetave kishte një ndasi në mes atyre që lexonin këtë gazetë dhe krahut tjetër më fanatik, që lexonte gazetën e Musa Jukës "Sedaja Milet" e që kërkonte shkronjat osmane.¹³⁵ Ajo që të bie në sy në aspektin e arsimit dhe kulturës shqipe në këtë periudhë kohore, 1908 – 1912, ndër të tjera edhe rivaliteti që del në pah ndërmjet Austrisë dhe Italisë, se kush po afron më shumë shqiptarët afër vetes. Që në vitin 1908 austriakët shqetësoheshin së ne vend dominojnë gazetatat italiane kundrejt atyre austriake. Së pari për faktin se janë më të lira dhe së dyti se edhe priftërinjtë që studiojnë në zonat gjermanisht folëse, kur vijnë këtu merren më shumë me italishten dhe nuk e ushtrojnë më. Një problem tjetër i dominimit italian në vend kundrejt tyre, ishte edhe prania e një kolonie të përhershme italiane me banim në Shkodër. Kjo gjë e cila i mungonte austriakëve, i jepte përparësi krahu tjetër. Madje edhe nëpunësit e bankës italiane në vend, kur vinin në Shkodër hynin në kontakt me vendasit, madje bënin

¹³¹ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1910, f. 456-458, Letër e Kontit Zambaur nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 12.01.1910.

¹³² AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1910, f. 144, Letër e At Gjergj Fishtës drejtuar Kontit Zambaur, Konsull Austriak në Shkodër, dt. 22.12.1910.

¹³³ Kraja, Musa. "Mësuesit për kombin...", f. 250.

¹³⁴ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f. 201-204, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar Markezit von Pallavicini, Stamboll, dt. 19.08.1909.

¹³⁵ Nika, Dom Ndoc. "Kujtime të një jetës...", f. 132.

edhe kontrata tregtare. Kjo joshje që i vinte popullit, ishte një e metë me të cilët vetë konti austriak i bënte kritikë Vjenës.¹³⁶

Rivaliteti shihej padyshim edhe në fushën arsimore. Hapja e jetimores për vajza nga motrat italiane, u bë me një pompozitet të madh, ku u bë promovimi nga konsullata italiane dhe u ftua edhe kleri i lartë katolik i Shkodrës. Ndërkohë hapja e jetimores për djem nga austriakët, ishte bërë në mënyrë modeste, ndaj kjo gjë shihej me zili nga ana e konsullatës. Madje kjo ngjarje ishte shikuar me aq vëmendje sa që edhe programi ishte vërejtur me detaje, duke theksuar se rreth 18 numra ishin në gjuhën italiane dhe vetëm një në gjuhën shqipe.¹³⁷

Njëkohësisht hapja e shoqatave italiane me qëllim kulturor dhe letrar si ajo “Dante Aligeri”, por që në vetvete mbarte propagandim italian, ishte nxitur nga austriakët që vetë shqiptarët ta kundërshtonin për mos italianizmin e qytetit. Kurse ajo që të bie në sy është elementi i shkollimit dhe raporti mes shqipes dhe italishtes në përdorim. Për austriakët përdorimi i italishtes në shkolla vinte dhe për mungesë të teksteve shqipe, ndaj kërkohej me çdo kusht dhe çdo çmim që librat të përktheheshin në shqip, dhe të paguheshin më shumë se asnjë herë vetëm për këtë qëllim.¹³⁸ Sepse interesi i shqipes shihej me interes më të lartë nga austriakët, vetëm që arsimit dhe ndikimi italian të mos ishte më i madh se ai austriak, sesa krahasuar me nevojat që vërtetë kishte qytetit për shqipen.

E gjithë kjo panoramë thekson më së miri, se situata kulturore në Vilajetin e Shkodrës, paralelisht ishte e lidhur edhe me nivelin politik të kohës. Ku spikaste jo vetëm e lidhur me politikën e Perandorisë Osmane të cilën ishte pjesë, por edhe paralelisht pjesë e ndikimit apo e rivaliteteve të Fuqive të Mëdha që në frymën e tyre ndihmuese kundrejt shqiptarëve, fshihej edhe elementi i dominancës së tyre në arenën ballkanike. Ose e parë nga këndvështrimi i përplasjes së forcave, interesat që shkapeshin në Ballkan, i jepnin dritë dhe ndriçonin edhe interesat e vendit tonë, kur u interesonte.

Referenca

- Arkivi i Ministrisë së Historisë (AMHSH), Fondi Arkivi i Vjetër (F. Ark. i Vj.), vëllimet 1908–1912. Korrespondencë diplomatike nga Konsullatat Austriake në Shkodër me Ministrinë e Jashtme në Vjenë dhe përfaqësi të tjera.
- Bala, S. (2011). *Historiku i shkollave dhe mësuesit e Shkodrës (1662–1945)* (Vëll. 1). Shkodër: Rozafat.
- Bartl, P. (2006). *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878–1912)*. Tiranë: Dituria.
- Demiraj, Sh., & Prift, K. (2008). *Kongresi i Manastirit*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Durham, E. (2013). *Shqipëria e Epërme*. Tiranë: Botimet IDK.
- Gawrych, G. W. (2007). *Gjysmëhëna dhe shqiponja*. Tiranë: Bota Shqiptare.
- Hoxha, F. (2014). *Vatër e dijes shkodrane: 100 vjet Shkolla 9-vjeçare Ismail Qemali*. Tiranë: Albas.
- Kastrati, J. (2022). *Faik Konica (jeta dhe vepra)*. Tiranë: Kristalina-KH.
- Kraja, M. (1993). *Mësuesit për kombin shqiptar*. Tiranë: Toena.
- Marku, P. (2024). Abat Preng Doçi, kleriku, atdhetari dhe intelektual shqiptar. *Kumbona e së Diellës*, 7–8, 28–31.
- Martini, L. (2012). *Abati i Mirditës Preng Doçi 1846–1917*. Tiranë: Mirgeeralb.
- Meta, B. (Kryered.). (2017). *Historia e shqiptarëve gjatë shek. XX* (Vëll. I). Tiranë: Botimet Albanologjike.
- Ndoj, G. (2009). *Antologji historike. Themele të ruajtura të një shtëpie evropiane të shembur*. Tiranë: Geer.
- Nika, D. N. (2003). *Kujtime të një jetës së kalueme*. Tiranë: Plejad.
- Qendra e Studimeve Albanologjike. (2013). *Shqipëri – Austri: Reflektim historiografik*. Tiranë: Botimet Albanologjike.
- Shaplo, S. (1975). *Nga historiku i zhvillimit të arsimit në Shqipëri*. Tiranë: Instituti i Studimeve Pedagogjike.
- Toleva, T. (2018). *Influenca e Perandorisë Austro-Hungareze në ndërtimin e kombit shqiptar (1896–1908)*. Tiranë: Dudaj.
- Vllamasi, S. (2000). *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897–1942*. Tiranë: Neraida.

¹³⁶ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f. 111-113, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 19.04.1909.

¹³⁷ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1909, f. 64-66, Letër e Kontit Kral nga Shkodra drejtuar baronit Fon Erental, Ministri i Jashtëm në Vjenë, dt. 10.06.1909.

¹³⁸ AMHSH, F. Ark. i Vj., V. 1910, f. 142, Letër e At Gjergj Fishtës drejtuar Kontit Zambaur, Konsull Austriak në Shkodër, dt. 22.12.1910